



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 22.12.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 20.12.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " **KIGA**" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve**", Nr. i prokurimit- 632-23-5490-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-068-121, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " **KIGA**" SH.P.K., e dt.20.12.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve**", Nr. i prokurimit- 632-23-5490-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-068-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 15.12.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 15.12.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

### A r s y e t i m

Me dt.20.12.2023, Operatori Ekonomik " **KIGA**" SH.P.K.ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "**Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve**", Nr. i prokurimit- 632-23-5490-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-068-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 22.12.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj nuk qëndron sepse Autoriteti kontraktues ka vendosur duke u mbështetur në Vendimin e OSHP:2023/0537, të datës 21.11.2023, sipas të cilit Paneli shqyrtues mbështetë raportin e Ekspertit shqyrtues se ju jeni i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj  
  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës